



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 185/24

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 21.10.2024



REPUBLICA E KOSOVËS VUSHTRRI - VUÇITRN KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **31 tetor 2024 (e enjte), me fillim në ora 10:00.** Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

* Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 shtator 2024.
2. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për hartimin e Draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2025
4. Shqyrtimi i Informatës për furnizimin me ujë të pijes në territorin e Komunës së Vushtrrisë
5. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe OJQ “Zëri i RAE”
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale ndërtimore të Komunës së Vushtrrisë
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës për përkrahje financiare për botimin e librit “Vushtrria në dokumentet osmane”
9. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me nr. protokollit nr.121/24 i datës 27.06.2024 për ofrimin e përkrahjes financiare për Klubin e Futbollit “Vushtrria”
10. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me nr. protokollit nr.153/24 i datës 25.07.2024 për ofrimin e përkrahjes financiare për Klubin e Hendbollit KHF “Samadrexha”
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për faljen e borxheve në taksat afariste për të gjitha bizneset nga 01.01.2000 deri 31.12.2017
12. Pyetje dhe përgjigje.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 182/24

Nr. i fq. / Br. st - 2 -

Data: / Datum 21.10.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

PËR:	Kuvendin e komunës
NGA:	Melihate Basholli Latifi <i>Melihate Basholli Latifi</i>
PËRMES:	Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë Sekretarisë së Kuvendit
TEMA:	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 21.10.2024

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 21 tetor 2024 ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

- Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formim të komisionit për hartimin e Draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2025.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
- Shqyrtimi i Informatës për furnizimin me ujë të pijes në territorin e Komunës së Vushtrrisë.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
- Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të përmirësohen disa gabime teknike dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
- Shqyrtimi i Draft-marrëveshjes së bashkëpunimit mes Komunës së Vushtrrisë dhe OJQ “Zëri i RAE”.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale ndërtimore të Komunës së Vushtrrisë.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
7. Shqyrtimi i kërkesës për përkrahje financiare për botimin e librit “Vushtrria në dokumentet osmane”.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që shkresa përcjellëse të nënshkruhet nga drejtori i drejtorisë dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
8. Shqyrtimi i Informatës për faljen e borxheve në taksa afariste për të gjitha bizneset nga 01.01.2000 deri 31.12.2017.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të përgatitet një Propozim-vendim dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS – VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E VII E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 26 SHTATOR, 2024

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën **10:23**. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Adnan Lahu, Alban Bajrami, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Basri Menxhiqi, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Faton Hyseni, Leonora Gërguri, Gentiana Rama, Gresa Muli, Kushtrim Hyseni, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Jeton Gjaka, Refik Maloku, Melihate Basholli-Latifi, Mek Selaci, Nurie Halili, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Spasoje Stefanoviç, Shkelzen Xhaferi, Sylejman Mehulli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent të gjithë anëtarë e zgjedhur të kuvendit, dhe kuorum është i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit- në fillim të mbledhjes, kërkoj nga një qytetare e cila incizonte mbledhjen që ta largoj kamerën nga salla, sepse e njëjta nuk ka autorizim për një gjë të tillë.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit- duke prezantuar para kuvendit, pyeti kryetarin e komunës se a është duke e mbikëqyrur ndokush projektin e sheshit të qyteti ku ka muaj ku janë prerë rrugët asfalti tek Lumi “Terrstena” dhe përgjatë Rr. “Vëllezërit Gërvalla” ku janë dëmtuar trotualet dhe gjendja ka disa muaj që është e njëjta, ndërsa projekti është dyvjeçar atëherë a duhet pritur dy vite deri sa të rregullohen këto rrugë. Më tej pyet se ka disa muaj që janë jashtë funksionit aparatet në laborator dhe shuma analiza nuk janë duke u bërë ku qytetaret detyrohen që privat ti marrin këto shërbime dhe kësaj po dëmtohen, kur do të gjendet një zgjidhje për këtë çështje.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit- në adresimin e tij para kuvendit tha se po bëhen gati tri vite të qeverisje së PDK-së në Vushtrri dhe pyetja është se ku jemi pas këtyre tri viteve? Çfarë ka bërë kjo qeverisje dhe ky Kryetar për këtë periudhë? Nuk kanë bërë asgjë, asgjë me shëndetësi, asgjë në arsim, në zhvillim ekonomik, në asnjë fushë të vetme. Në premtimet e juaja ishte ndërtimi i së paku katër çerdheve në Vushtrri, të dashur qytetar, a e dini se sa çerdhe janë ndërtuar nga ky

pushtet? Asnjë! Keni premtuar trajtim të qenve endacak, dhe më duket se i keni trajtuar, por jo duke u munduar ta zvogëlioni numrin e tyre por duke e rritur, sot qytetaret tanë janë të rrezikuar në çdo cep të Vushtrrisë nga qenet endacak, dhe çfarë keni bërë ju për tri vite? Asgjë! Mos të flasim për ujin, e kemi thënë për të saten here aty ku e kemi lënë këtë projekt aty ka mbetur. A mund ta dimë se sa kycje të reja janë bërë gjatë këtyre tri viteve Kryetar, a mund të dimë se ne çka konkretisht janë paraparë 3 milion euro për ujësjellësin, kur të gjitha punët ju kemi lënë të përfunduara, por fatkeqësisht edhe këtu nuk dimë asgjë. Keni themeluar Drejtori për Investime Kapitale, dhe normalisht se të gjithë kemi pritur që investimet kapitale do të rriten, çfarë ndodhi, investimet kapitale për këtë vit u zvogëluan për gati 2 milion euro! Pse ndodhi kjo Kryetar, apo keni gabuar në emërtim të Drejtorisë që e keni themeluar, ndoshta e keni menduar si Drejtoria për zvogëlimin e investimeve kapitale? Të dashur qytetar të Vushtrrisë, kjo qeverisje i zvogëlon investimet kapitale për 2 milion euro, ndërsa rritë shpenzimet për mallra dhe shërbime për 2 milion euro. Zvogëlon investimet aty ku përfiton qytetari, ndërsa ka rritur luksin për vete dhe për vartësit e tij. 99 fije me qytetarin dhe një me PDK-në, kështu thoshte Kryetari në fushat, ndërsa këto tri vite nuk ke mundësi të arrish te një vend pune nëse nuk e ke librezën e PDK-së. Çdo punësim është bërë në baza partiake.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-pasi i përshëndeti të gjithë të pranishmit, vlerësoi se kuvendi ishte në pushim për më tepër se një muaj, por gjërat e këqija nuk kanë ndaluar së ngjari në Komunën e Vushtrrisë, kjo për faktin se Komuna e Vushtrrisë ka lidhur kontratë për furnizim me dru apo lëndë degjëse për shkollat e komunës në vlerë rekorde prej 940,500.00 €, dhe për ta bërë këtë kontratë të dëmshme për interesin e komunës është fakti se klauzola e kësaj kontrate del që për 400,000.00 € kjo kontratë të jetë më e shtrenjtën se sa operatori më i lirë ekonomik. A ka logjik ligjore, logjik ekonomike e zhvillimore që të lidhet një kontratë më e shtrenjtë për mbi 400 mi ero, kjo bënë që metri i druve të jetë paguar mesatarisht 82.5 € në Komunën e Vushtrrisë, dhe nëse bëhemi të sinqertë cili prej nesh do ta paguante një vlerë të tillë për një metër dru asnjëri. Kjo nuk është e tëra kryetari i komunës ka lidhur kontratë në vlerë prej 250,000.00 € për mbikëqyrjen e projekteve dhe imagjinoni nuk po mjafton stafi i komunës dhe po kontraktohet kompani për një gjë të tillë me hiq më pak se një çerek milioni për një gjë të tillë me taksat e qytetarëve. Për më tepër edhe më keq ky operator ekonomik nga të dhënat e ARBK-së ka vetëm 10 punëtor, ndërsa 300 punëtor të komunës po jenë të pamjaftueshëm për ti mbikëqyrur projektet kapitale në Komunën e Vushtrrisë, për çfarë po flasim për cilën ide të zhvillimit, apo nuk po i përshtaten kryetari të komunës stafi i komunës apo nuk po i mjaftojnë, në vitin 2024 kemi ardhur në një gjendje që një firmë private të na bëj pranimin e projekteve të komunës dhe imagjino se cila është gjendja aktuale e komunës. Më tej kryetari i komunës ka lidhur kontratë prej 995 € në muaj për veturë personale, imagjino sa familja ka nevojë për strehim dhe për qira në Vushtri, ndërsa kryetari paguan shuma marramendëse për veturë personale. E kemi parë rregullimin e sheshit që është prezantuar se mega projekt me ato muret të stilit kinez, por tash pas kritikave, ka filluar të ndërtoj tribuna të stilit grek. Çfarë logjike ka të ndërtohen tribuna në shesh, kush është ai projektor i këtij projektit skandaloz. Furnizimi me ujë të pijes ka qenë premtim që do të rregullohet për 6 muaj dhe asnjë hap nuk është ndërmarr as në zgjerim të rrjetit dhe për këto të gjitha këta duhet të bartin përgjegjësi para qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-pika qendrore e diskutimit të tij ishte takimi i kryetarit të Këshillit Lokal z.Femi Shala dhe drejtoreshe së shkollës fillore “Migjeni” me një organizatë joqeveritare të quajtur CIPOS, konkretisht znj.Mevlude Murtezi me seli në Prishtinë, në njoftimin zyrtar që është bërë thuhet se është lidhur marrëveshje për ngritjen e një çerdhe në fshatin Stanoc

i Epërm ashtu që të ngritet standardi në arsimin parauniversitar, ndërsa më datën 27.09.2024 njoftohet se do të mbahet një takim për këtë çështje ku do të marrin pjesë kryetari i komunës, përfaqësuesit e fshatit dhe përfaqësuesit e kësaj organizate. Për këtë çështje ai pyeti se për çfarë marrëveshje bëhet fjalë, mundësisht kërkoj kopjen fizike të kësaj marrëveshje, a do të iu jepet objekti i shkollës në shfrytëzim kësaj shoqate dhe cilat janë kushtet e marrëveshjes, cili do të jetë roli i shoqatës CIPOS dhe për çfarë mbështetje bëhet fjalë mbështetje financiare, logjistike, burime njerëzore. A janë respektuar procedurat ligjore gjatë kësaj marrëveshje dhe cili do të jetë roli i komunës në këtë marrëveshje kur dihet se ish objekti në fjalë i shkollës “Migjeni” është pronë e komunës. Prandaj kërkojë nga kryetari i komunës dhe kryesuesja e kuvendit që të respektojnë 1.Rekomandimin e Komisionit Komunal të themeluar nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, 2.Vendimin e Kuvendit Komunal të datës 29.09.2022 në bazë të cilit ky objekt duhet të rinovohet dhe të shndërrohet në çerdhe publike, 3.Vendimin e Kuvendit Komunal të datës 26.09.2023 në të cilën ndahen mjetet për renovimin e këtij objekti për çerdhe dhe 4.Të merret parasysh aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datë 01.02.2024.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-parashtror një kërkesë për ish-arsimtarin e Kimisë dhe Fizikës z.Rexhep Haradinaj, që nga vërshimet e viteve 2020/21 shtëpia iu është dëmtuar, më datën 19.08.2024 ka parashtruar një kërkesë, tek kryesuesja e kuvendit, e cila e ka bartur këtë kërkesë tek Komisioni për vlerësimin e dëmeve por që është konstatuar se nuk ka mjete për këtë vit, kërkoj që vitin e ardhshëm ti ndihmohet me subvencionim që të rinovoj shtëpinë e tij. Lidhu me çështjet e ngritura nga anëtarë të kuvendit z.Ymer Haradinaj, sqaroi se aktivitet lidhur me çerdhen në fshatin Stanoc i Poshtëm, është organizuar nga Këshilli i Fshatit dhe Organizata CIPOS ku ka për qëllim funksionalizimin e çerdhes në fshatë, prandaj nesër mbahet takim dhe jemi të hapur që të japim ide që kjo çerdhe të bëhet.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-sqaroi se gjithëherë ka qenë dhe është pro që të bëhet çerdhja në fshatin Stanoc i Epërm, por gjithnjë duke respektuar vendimet që janë marr në këtë kuvend. Ai ceku se ka munguar projekti dhe kërkesa nga ana e ana e komunës për MASH TIN për ta bërë çerdhen në këtë fshatë.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës, pasi i përshëndeti të pranishmit deklaroi se do të tentoj që në pika kryesore tu përgjigjet çështjeve të ngritura nga anëtarët e kuvendit. Ai informoj dhe konsideroj se dëmin më të madh jemi duke ja shkaktuar vetit nga paragjykimet tona. Lidhur me çerdhen në ish objektin e shkollës “Migjeni” ka pretuar publikisht se do ta bëj çerdhe, objektet të cilin qeverisja e kaluar e kishte shndërruar në fabrikë tekstili. Më tej kërkoj vëmendjen e anëtarëve të kuvendit gjatë diskutimit dhe po ashtu kërkoj nga kryesuesja e kuvendit që respektoj dhe zbatoj rregulloren e punës së kuvendit. Pastaj sallën e sportin në SHUM2 e ka nisur vetë ministria dhe e ka lënë si gërmadhë për 4 vite. Sa i përket çerdhes në fshatin Stanoc, njoftoj se ka lobuar që ajo shoqatë të vjen dhe të investoj në ngritjen e asaj çerdhe dhe për çdo gjë do merret vendimarrja në kuvend. Problematika kryesore tek çerdhet është rekrutimi i stafit, por beson se organizata që do të financoj çerdhen do të gjej zgjidhje edhe për sa i përket rekrutimit të stafit. Lidhur me kontratën për furnizim me lëndë djegëse njoftoj se kjo kontratë ndodhet në OSHP dhe e njëjta është kontratë kornizë në afat tre vjeçar e që krijon përshtypjen se është me çmim të shtrenjtë për njësi, dhe shtoj se nëse ka dyshim atëherë menjëherë duhet të denoncohet në organet e drejtësisë. Tutje shtoj se kontaktimi i kompanisë për mbikëqyrje të projekteve është më se i domosdoshëm, sepse pikërisht që nuk ka pasur mbikëqyrje adekuate ka ndodhur që shkallët e QKMF-së të jeni sa të një banës që e kanë bërë atë qendër jo funksionale. Lidhur me çështjen e furnizimit me ujë të pijes, sqaroi se kjo punë nuk mund të matet me përqindje por mund të thuhet se rrjeti i shtrirë para disa viteve ka qenë i dëmtuar dhe përpjekjet janë maksimaliste për përfundimin e këtij projekti.

Në fund lidhur me punësimet në administratën komunale njoftoj se ka pasur punësime nga të gjitha subjektet politike sepse mbi të gjitha ata janë qytetar të lirë të kësaj komune pa dallime partiake e politike.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-lidhur me shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit, demantoi konstatimin se kyçjet individuale në rrejt në fshatin Smrekonicë dhe Samadrexhë, kanë qenë të përfunduara në mandatin e kaluar, kurse në këtë mandat nuk është punuar asgjë në këtë relacion. Ai përsërit se të gjitha punësimet janë bërë mbi baza partiake duke i favorizuar militantë e partisë në pushtet.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-sqaroi se në mandatin e kaluar, qytetarëve iu janë marr nga 80 € taksë për kyçje në rrjetin e ujësjellësit, dhe përsëri nuk ka pasur ujë, në mandatin e tij është bërë kompletë rikonstruktimi i rrjeti dhe i pompave të ujësjellësit dhe tani ka ujë në fshatrat e cekura si më lartë.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-vlerësoi se kur flitet për mbikëqyrjen e projekteve ashtu që mendohet që mos të ndërtohen dy here të njëjtat projekte, atëherë duhet marr për bazë pikërisht partinë në pushtet e cila para dhjetë viteve e ka ndërtuar sheshin e qyteti dhe tani përsëri po investon miliona euro në po të njëjtin projekt. Po ashtu edhe fabrika e ujit projekt milionësh, është projektuar gabimisht, dhe në vend jo adekuat dhe për këtë po duhet të investohen miliona mjetet për pompa termike për ta lëshuar ujin dhe për këto projekte duhet ti marr përgjegjësit partia në pushtet aktualisht.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se fabrika e ujit në Vushtrri, është nga projektet më të vlefshme për të cilën ia kanë lakim shumë Komuna në Republikën e Kosovës, pavarësisht se munde të ketë pasur defekte të caktuar gjatë projektimit dhe ndërtimit të saj. Lidhur me sheshin vlerësoi se ai nuk po punohet për herën e dytë, sepse asnjëherë nuk ka pasur parking nëntokësor në shesh e tani po bëhet dhe është projekt shumë i mirë.

Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 26 vota “për” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 25 korrik 2024.
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – buxhetit për vitet 2025 – 2027 dhe planeve investuese.
3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese, për periudhën janar – qershor 2024.
4. Shqyrtimi i Raportit i sistemit të menaxhimit të performancës dhe grantit të performancës për vitin 2023.
5. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2023/2024.
6. Shqyrtimi i nismës së Kryetarit të Komunës për bashkëpunim ndërkomunal për bashkëfinancim me Komunën e Mitrovicës për rregullimin e memorialit të dëshmorit Xhevat Jusufi.
7. Rishikimi i Planit të veprimit për të gjeturat e auditorit.
8. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje – shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore.
9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjastëmujorin e parë të vitit 2024.

10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit Nr.01-63/24 i datës 28.03.2024 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.

11. Pyetje dhe përgjigje.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 25 korrik 2024.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me 28 vota “për”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 25 korrik 2024.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – buxhetit për vitet 2025 – 2027 dhe planeve investuese.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-duke ju adresuar qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë dhe anëtarëve të kuvendit, njoftoj se pas dëgjimeve buxhetore dhe marrjes së kërkesave të qytetarëve për projektet e ndryshme është hartuar propozim-buxhetit i Komunës së Vushtrrisë të cilën e kemi sjell sot para jush për aprovim. Ai vlerësoi se viti që lamë pas ishte viti më sfidues financiar për Komunën e Vushtrrisë dhe qytetaret e saj. Këto sfida financiare për komunën do të reflektohen edhe në vitin 2025, për faktin se nga nëntori i viti të kaluar komuna ka paguar afër 6 milion euro obligime që kanë dalë nga Kontrata Kolektive e Arsimit pagesa për mësimdhënësit e Komunës së Vushtrrisë. Kjo ka ndodhur si rezultat se Ministria e Arsimit, nuk i ka paraparë mjetet për mbulimin e këtyre obligimeve që dalin nga kjo kontratë. Kësisoj Komuna e Vushtrrisë ka shkuar përmes procedurës së ndërmjetësimi dhe është shpëtuar ajo ka është mundur duke dal një kosto pak më lehtësuese për komunën. Në krejt këtë proces humbës janë vetë dy palë komuna dhe mësimdhënësit, sepse shumë nga këto mjete komunës i janë marr nga investimet kapitale dhe për më keq janë marr nga projektet që kanë qenë të kontraktuara dhe në fazën e ekzekutimit të tyre, ndërsa ata që kanë fituar të vetmit janë avokatët. Pastaj shtoj se në projeksionet buxhetore për vitin 2025 është paraparë rritja e vlerës së subvencioneve, për afro 600,000.00 € ku do të rritet edhe vlera e subvencioneve për gratë lehona, si dhe planifikojnë që të subvencionohen ato kategori e fusha që do të gjenerojnë vend të lira të punës. Po ashtu në kuadër të kategorisë së subvencioneve do të ndihmohen edhe bizneset që janë dëmtuar gjatë punimeve në sheshin e qytetit. Në vitet e kaluara është investuar në shkathësit e buta në gjuhët e huaja ndërsa komuna i ka rimbursuar ato mjete në vlerë totale prej 160,000. €. Sa përket investimeve kapitale këtë vit ato janë më të vogla, dhe njoftoj se kanë pasur takim me bankën austriake dhe komuna ka aplikuar për një kredi të butë, këtë gjë e kanë bërë shumë komuna të Republikës së Kosovës, dhe për këtë periudhë fillon pagesa e kësteve pas tri viteve që akordohet kredia, ndërsa kamata është vetëm 1%, tani çështja ka mbetur tani tek Ministra e Financave e cila duhet ta garantoj këtë kredi. Kjo kredi do të shërbente në kompletimin e mozaikut të infrastrukturës së përgjithshme për Komunën e Vushtrrisë. Më tej ai vlerësoi se gjendjen e rënduar financiare të komunës, e ka zbutur sa do pak projektet që i kemi bërë me bashkëfinancim me disa ministri dhe me organizata tjera ndërkombëtare. Në fund vlerësoi se buxheti për vitin 2025 në masën e përgjithshme është i kontraktuar dhe ka presion edhe për projektet tjera kapitale nga ana e qytetarëve por buxheti është ky dhe ai në totalitet është shpenzuar në mënyrë racionale, andaj bëri thirrje se ky buxhet i cili është për qytetaret të votohet nga të gjitha subjektet politike në mënyrë unanime.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me propozim-buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025, i cili është hartuar konform instruksioneve të MFPT dhe qarkoreve buxhetore të pacaktuara nga ana e ministrisë kompetente për Financa. Ai njoftoi se planifikimi i buxheti është hartuar duke i ndjekur të gjithë hapat ligjor sipas legjislacionit në fuqi duke ndjekur të gjitha standardet e para tek parimet, burimet e financimit dhe kategoritë ekonomike dhe shpërndarjen e mjeteve në kodet dhe programet buxhetore. Lidhur me zvogëlimin e një pjese të mjeteve për investime kapitale dhe rritjen e mallrave dhe shërbimeve, sqaroi se kjo ka ardhur si rezultat se me një udhëzim administrativ lejohet që një pjesë e shërbimeve kontraktuale për investime kapitale të paguhet nga kategoria mallra dhe shërbime.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-duke ju adresuar qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë deklaroi se sot po shqyrtohet njëra ndër pikat më të rëndësishme të kuvendit dhe komunës në përgjithësi në një vit kalendarik, dhe krejt në fillim vlerësoi se në dy vitet e para që qeverisjes Idrizi, grupi kuvendar i LVV-së e kishte votuar buxhetin e komunës, duke ia dhënë mundësinë kryetarit të komunës që të realizoj premtimet dhe zotimet e bëra në fushatën elektorale por si duket kjo zemërgjerësi ishte keqpërdorur nga ana e pushtetit aktual. Ajo çka vlen të theksohet është fakti se kryetari i komunës, ka dështuar në realizimin e projekteve të cilat vetë i ka planifikuar dhe i ka paraparë sepse vetëm në fund të vitit të kaluar i ka pasur rreth 160 projekte të cilat nuk i ka filluar fare, dhe ajo çfarë duhet të bëhet publike është se ajo që ka ndodhur në këto tri vjet dhe ajo çfarë do të ndodh edhe vitin e ardhshëm është se këtu në kuvend votojmë buxhet dhe kode buxhetore, për të cila shkojnë dhe ju thonë qytetarëve se ja ku projekti i caktuar është i planifikuar në buxhet dhe ai projekt nuk realizohet kurrë. Pra pyetja esenciale që duhet të parashtrahet është se ku kanë mbetur dhe cili është fati i projekteve që janë votuar dhe buxhetuar më herët në këtë kuvend. Arsyetimet e vazhdueshme të kryetarit të komunës janë që mjetet po merren nga gjykatat dhe përmbaruesit privat, për mësimdhënësit e Komunës së Vushtrrisë, por qe dikur kryetari i komunës iu thoshte këtyre të fundit se fare nuk do të kenë nevojë të shkojnë tek avokatët dhe gjykata për ti realizuar këto të drejta. Duke e vlerësuar projekt-buxhetin për vitin 2025 vlerësoi se asnjëherë buxhet më të dobët nuk është sjellë në kuvend për aprovim. Kjo arsyetohet se kemi vetëm një faqe që elaburon projektet kapitale dhe koj ka ndodhur ndoshta për shkak të afektimit të kontratave, por për pasoj kjo ka ndodhur sidomos për shkak të keq planifikimit. P.sh planifikimi i rindërtimit të sheshit është i dëmshme sepse për ta mbushur të ashtuquajturën “gropën e Hajdinit” në shesh duhet të dedikohet gati i gjithë buxheti për kapitale ashtu që në vitin zgjedhor të mbyllet kjo gropë sepse për këtë projekt në vitin 2025 duhet të paguhet 1,120.000.00 € dhe tani kemi turrje të projekteve kapitale për qytetarë dhe rajon tjera duhet të vuajnë nga mungesa e projekteve bazike. Kjo është e dëmshme dhe logjike e mbrapshtë dhe mashtruese, dhe deklaroi se ky buxhet është për ti mashtruar qytetarët dhe atë nuk e votojnë jo pse është z.Idrizi kryetar por sepse është buxhet i mashtrimit qytetarë. Për ta argumentuar se si qytetarët po provohen të mashtrohen është shembulli: projekti rehabilitimi i rrugëve në fshatrat Vërnice, Sallcë, Akrahticë, Bukosh dhe Dolak, planifikimi 25,000.00 €, dhe shtrohet pyetja se çfarë rehabilitimi mund të bëhet në 5 fshatra me këtë shumë parash, kjo është qesharake. Mandej vazhdon logjika e tentim mashtrimit, projekti ndërtimi i rrugëve lokale në fshatrat: Dumnicë e Poshtme, Maxhunaj, Stanoc Lumadh, Vilancë, Ropicë dhe Pestovë shuma e projektit 25,000.00 €. Tutje ndërtimi i rrugëve: Banjskë, Sllatinë, Begaj dhe Smrekonicë shuma e projektit 50,000.00 €, kjo shumë është sa për të iu qitur hi syve qytetarëve për ti mashtruar por kjo është qasje e gabuar. Pastaj ndërtimi dhe rikonstruktimi i fushave sportive në fshatrat: Maxhunaj, Lumadh, Stanoc, Reznik, Pestovë, Dobërllukë, Pantinë, Shtitaricë, Novolanë dhe Bruznik shuma e projektit 50,000.00 € d.m.th të gjitha këto fusha do të ndërtohen me këtë shumë financiare kjo për pos që është mashtruese është edhe për keq ardhje. Tek rrejt i

ujës-jellësit-ndërtimi i stacionit të pompimit ku për vitet 2025-2027 janë planifikuar 2,100,000.00 €, dhe kjo i bie që edhe tri vitet nuk do të përfundon projekti i ujit të pijshëm. Dhe ajo që është edhe më qesharake dhe skandaloze është fakti se janë themeluar dy drejtori të reja dhe në planifikimet buxhetore për vitin 2025 nuk është paraparë asnjë cent në këto drejtori, kjo i bie se ato janë themeluar vetëm për ti punësuar dy drejtor. Në fund tha se edhe projektet me bashkëfinancim nuk figurojnë në tabelat buxhetore dhe kjo është shumë keq ai përsërit se ky buxhet është kundër interesave të qytetarëve dhe si i tillë grupi kuvendar i LVV-së nuk do ta përkrahin.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-tha se në tablat buxhetore evidentohen disa projekte siç është kanalizimi Vushtrri, Samadrexhë, Maxhunaj Stanoc, fare nuk ka buxhet që do të ishte paraparë. Mandej tek planifikimi mjedisor dhe inspektimet është evidentuar projekti në fshatrat: Vërnice, Sallcë, Akrashticë, Bukosh dhe Dolak, që ka të bëjë me rehabilitimin e rrugëve janë planifikuar 25,000.00 € dhe kjo shumë është simbolike sa për të thënë se kemi ndarë mjete. Tek fshatrat Strofc, Zhilivodë, Bivolak dhe Beçuk po ashtu janë planifikuar 25,000.00 €. Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatrat Dumnicë, Maxhunaj, Ropicë, Vilanc janë ndarë 25,000.00 €, ndërsa në dy fshatra Gracë dhe Prelluzhë vlerat janë të dyfishuara në 50,000.00 €. Më tej tek ndërtimi i rrugëve lokale Bukosh Novolan Dolak shuma 10,000.00 €, dhe përsëri se rruga në fshatin Dolak është shkartuar po thuajse tërësisht, andaj kërkoj që kjo rrugë specifikisht të parashihet në buxhet se ka rrezik që kjo rrugë gjatë këtij dimri të bëhet e pakalueshme. Për Qendrën Rezidenciale në Lumadh janë planifikuar 15,000.00 € për blerjen e një auto-veture, por kërkoj të ketë më shumë mjetet për një automjet që do ti barte peronat rezident në këtë qendër. Në Drejtorinë për Kulturë edhe vitin e kaluar janë paraparë ndërtimi i 10 fushave të sportit në vlerë prej 100,000.00 €, por që këto projektet nuk janë përfunduar, ndërsa për vitin 2025 janë ndarë vetëm 50,000.00 € dhe kjo do të jetë tepër e vështirë të përfundohen.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit-tha se në vitet e mandatit të kaluar asnjë cent nuk është investuar në fshatin Pasomë, dhe tani është e turpshme që dikush të flas për mos investime në këtë fshatë.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-duke iu adresuar qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, njoftoj se grupi i LDK-së për dy vite e kishte votuar buxhetin e Komunës, duke mos dashur të bllokuese e proceseve komunale. Më tej shtoj se të njëjtën gjë nuk e kishte bërë pushteti aktualë dikur në opozitë ashtu që në vitin 2021 vetëm për inate politike nuk e kishte votuar buxhetin e Komunës pasi që ishte vit zgjedhor dhe i kishte bllokuar proceset buxhetore për qytetarët e komunës së Vushtrrisë. Tutje shtoj se nëse e shohim buxhetin për vitin 2021 ai është shpenzuar në masën vetëm prej 16%. Në vitin 2023 është vazhduar njëjtë ku as gjysma e buxhetit ishte shpenzuar. Sot ndodhemi para momenti të votimit të buxhetit për vitin 2025, por që fatkeqësisht ky buxhet nuk është i qytetarëve, por është buxhet i PDK-së i hartuar në Brezovicë. Në fund ai tha se meqë ky buxhet nuk ka përmbajtje dhe nuk është zhvillimor atëherë ata nuk do të mund ta përkrahin. Krejt në fund duke marr shembull fshatrat Beçuk, Stroc, Bivolak dhe Zhilivodë, ku për rrugë janë paraparë vetëm 10,000.00 € kjo është vetëm sa për të iu qitur hi syve qytetarëve sepse këto projekte me këto mjete nuk do të mund të realizohen.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-vlerësoi se pa dashur të zgjatet në diskutime deklaroi se projekt-buxheti i komunës për vitin 2025, është një buxhet zhvillimor dhe për qytetarët sepse i njëjti është shpërndarë konform kërkesave dhe nevojave të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Më tej shtoj se buxheti për vitin 2025 është gjithëpërfshirës në të gjitha lokalitetet e Komunës dhe ai prekë të gjitha fushatë si arsimin, kulturën sportin dhe rininë. Në vazhdim ai vlerësoi se me buxhetin e komunës që është për qytetarët nuk duhet të bëhet politikë, sepse ai reflekton direkt në

jetën e qytetarëve dhe mos aprovimi i tij është dështim dhe nuk konsiderohet fitore politike për asnjë subjekt politikë të përfaqësuar në kuvend. Në fund ai deklaroi se e mbështet projekt-buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025 dhe bëri thirrje që ai të votohet unanimisht nga të gjithë.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se kur bëhet fjalë për votimin e buxhetit të komunës, si dokumenti më i rëndësishëm fiskal vjetor, atëherë asnjë subjekt politikë nuk duhet ti dëgjoj liderët e tyre në qendër, por duhet të votojnë lirshëm pa presion sepse po votojnë në favor të qytetarëve. Pastaj përsërit se është shqetësuese fakti se anëtarët e opozitë në Vushtrri që janë në pushtet në qeverinë e Kosovës, asnjëherë nuk e ka ngritur zërin që mjetet për mësimdhënësit për mbulimin e obligimeve që dalin nga kontrata kolektive, ti mbuloj Ministria e Arsimit përkatësisht ajo e Financave dhe shtoj e konsideroj se si kryetar i komunës nuk mundur të bëj më shumë në aspektin juridike për mësimdhënësit se sa përmes ndërmjetësit të qesin parat që iu takojnë mësimdhënësve. Lidhur me ndërtimin e rr. Në fshatin Dolak, njoftoi se projekti detal është hartuar dhe shpreson se përmes bashkëfinancimit ky projekt të përfundoj shumë shpejt.

Behar Duraku, anëtar i kuvendit-duke demantuar diskutimin e anëtarit të kuvendit z.Adnan Lahu, deklaroi se për investimet në pesë fshatrat: Stroc, Beçuk, Bivolak, Gllavatin dhe Zhilivodë, janë paraparë rreth 50,000.00 €, dhe këto mjete kryesisht për rikonstruktimin dhe shtrimin e disa rrugicave, sepse pjesa dërmuese e projekteve në këto fshatra janë përfunduar. Tutje shtoi se buxhetit është dokumenti kryesor i komunës dhe duhet votohet nga të gjithë sepse ai është për qytetarë. Ai apostrofoi se këta që po refuzojnë sot të votojnë buxheti duke moralizuar fallco, nesër do të dalin për të kërkuar vota, ai apeloj tek qytetarët që ti mbajnë mend këto figura që mos ti votoj sërish për ti bërë pjesë të kuvendit.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se nëse krahasojmë buxhetin e komunës për vitet 2024 dhe 2025, shihet se për investime kapitale, për vitin 2024 kemi pasur për mbi 6 milion euro, apo në përqindje 26% e buxhetit total të komunës, ndërsa për vitin 2025 kemi pak më shumë se 5 milion euro në investime kapitale apo shprehur në përqindje 19.18%, pra bie në sy se për vitin 2025 kemi një planifikim më të ulët për 7.81% në krahasim me vitin e kaluar apo 1,849.891.00€. Tek planifikimi i buxhetit me përgjegjësi të plot deklaroi se nuk janë marr për bazë kërkesa e qytetarëve që janë adresuar gjatë takimeve buxhetore siç është rasti në Stanoc, ku në takim nga qytetarë është kërkuar të ndahen 5000€ për ndërtimin e pllakës përkujtimore për 22 të vararët gjatë luftës së dytë Botërore. Kërkoj që kjo shumë të futet në buxhet për vitin 2025 tek kodi buxhetor ndërtimi i lapidarit në fshatin Pasomë të shtohet edhe kjo shumë financiare. Buxheti kryesisht është i përgjithësuar dhe shihet se qëllimshëm nuk janë specifikuar emrat e rrugëve nëpër fshatra që lejnë mundësinë për manipulim dhe kjo do të shkaktoj pabarazi qytetare në shpërndarjen e investimeve kapitale kur dihet edhe fakti se viti 2025 është vit zgjedhor në Republikën e Kosovës në nivel nacional dhe lokal. Mandej shtoj dhe vlerësoi se nuk kemi investime në rini dhe sport, tek arsimi janë paraparë mjete financiare për ndërtimin e Çerdhes në fshatin Smrekonicë vlera 40,000.00 € dhe ndërtimi i çerdhes publike në fshatin Bukosh po ashtu 40,000.00 € dhe këtu shtoj pyetjen se a mjaftojnë këto mjetet për ngritjen e këtyre çerdheve. Më tej po ashtu në arsim investimet janë tejet minimale në shkollat e mesme të larta p.sh në gjimnaz janë paraparë 22,000.00 €, kurse është anashkaluar shkolla e mesme teknike dhe shkolla e mesme profesionale. Ai përsëriti propozimin e tij që të futet në buxhet blerja e një minibusi për shkollën e mese teknike dhe atë profesionale i cili do të mundësonte që nxënësit ta realizojnë praktikën profesionale në ndërmarrjet e ndryshme. Në fund kërkoj që të merren për bazë kërkesat e tij dhe të kemi një shpërndarje të drejtë dhe reale të buxheti të komunës për vitin 2025.

Në vazhdim, anëtarët e kuvendit nga grupi kuvendar i LDK-së dhe LVV-së, lëshuan sallën e mbledhje, duke shprehur mospajtimin e tyre më mënyrën dhe përbërjen e hartimit dhe projektimit të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-duke ju adresuar qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, deklaroi se sigurisht që qytetarë tanë na përcjellin në secilën seancë të kuvendit, se ne a po i përmbushim përgjegjësit tona të cilat na i kanë dhënë përmes votës së tyre. Në e dimë se një buxhet i mirëfilltë duhet të ketë bazën e tij për një planifikim të mirë. Baza për këtë planifikim të mirëfilltë është plani zhvillimor i komunës, pra ky buxhet nuk bazohet në këtë plan. Kjo qeveri komunale funksionon pa Plan Zhvillimor Komunal dhe pa Harta Zonale, dhe ky buxhet me asnjë kod ekonomik-buxhetor nuk bazohet në këto plane. Prandaj këtë nuk mund ta quajmë buxhet zhvillimor të komunës, ashtu siç nuk ka ndodhur edhe në vitet paraprake nga qeveritë e kaluar. P.sh. keni planifikuar infrastrukturë sportive, ndërsa terrenet sportive i kemi në gjendje tmerruese si fusha e gomës, fusha sportive në fshatin Doberllukë, fusha sportive në fshatin Samadrexhë po ashtu janë në një gjendje tmerruese. Fushat dhe sallat sportive që janë planifikuar nga qeverisja e kaluar janë në një gjendje tmerruese, akoma të teknikisht të pa pranuar. Keni pak planifikim në barna esenciale dhe kjo reflektohet çdo ditë tek qytetarë që kanë probleme shëndetësore. Keni planifikuar ndërtim të rrugëve, por që kemi staza të hapura të rrugëve të cilat lere që nuk i keni përfunduar por janë shndërruar në gërmadha. Nuk kemi investime në rrugët e qytetit që janë në gjendje të mjerueshme, për shkak se ato nuk janë mbikëqyrur nga persona përgjegjës dhe profesionit të fushës. Në arsim duke filluar nga ngecja në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe deri tek mos kujdesi për hapësirat sportive që janë në gjendje tmerruese, dhe kontraktimi skandaloz i shërbimit me lëndë djegëse-drutë për shkolla që është bërë top lajmë këto ditëve të fundit. Në bujqësi përkrahja për bujqit deri tani është zero. Në shërbime publike keni planifikuar ujë, kanalizim, trotuar e shumë shërbime tjera si prerja e rrugëve, kompanitë private i kanë sjellë këto rrugë në gjendje të mjerueshme. Ky draft i paraqitur sot para nesh duke se është përqendrua në investime kapitale, por e vërteta është e kundërt se kemi dobësi në investime në infrastrukturë, shëndetësi, arsim dhe shërbime publike që janë prekur drejtpërdrejt nga mos realizimi i tyre. Në fund vlerësoi se veprimet e tij politike në këtë kuvend nuk varen nga thirrjet e disa individëve që shytën nga pazaret e ndryshme politike dhe të njëjtit bëjnë thirrej për qëndrim në sallë të mbledhje dhe për ta lëshuar atë ata nuk kanë kurrfarë kredibiliteti. Për më tepër atij i vjen shumë keq që disa koleg anëtarë të kuvendit nga grupi i tij tash e tri vite qëndrojnë në seancë dhe marrin pagë nga ky kuvend dhe për tri vitet nuk e kanë ngritur as edhe një çështje për interes të qytetarit, kjo është për keqardhje se kush i përfaqëson qytetarë e Komunës së Vushtrrisë. Veprimi i tij politik është lëshimi i sallës së mbledhjes sepse ky projekt-buxhet nuk i adreson interesat e qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesja e kuvendit konstatoj se në sallën e mbledhjes janë të pranishëm 20 anëtarë të kuvendit dhe procedoj me votimin e pikës së rendit të ditës Propozim – buxheti për vitet 2025 – 2027 dhe planeve investuese.

Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votomi me 17 vota “për” 2 vota “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë dhe lista e projekteve kapitale për vitet 2025-2027, konform Qarkoreve Buxhetore 01/2025 dhe 02/2025, të lëshuara nga MFPT-ja.

2. Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025 është: **27,662,762.00** € prej të cilave për:

Kategoritë Buxhetore	2025	2026	2027
Paga	13,811,153.00	14,570,767.00	15,343,017.00
Mallra dhe shërbime	6,324,837.00	6,451,334.00	6,580,360.00
Komunali	639,625.00	668,408.00	701,829.00
Subvencione	1,855,000.00	1,947,750.00	2,103,570.00
Shpenzime kapitale	5,032,147.00	5,363,202.00	5,645,366.00
TOTALI	27,662,762.00	29,001,461.00	30,374,142.00

3. Të hyrat vetanake të planifikuara.....**3,525,467.00** €.

4. Mjetet financiare të cekura në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi janë në pajtim me Qarkoret Buxhetore 01/2025 dhe 02/2025 të MFPT-së, si dhe në bazë të kufijve buxhetorë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Kryetari i komunës dhe drejtoritë e tjera kompetente komunale.

6. Tabela: 4.1- plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2025-2027; tabela 4.2 – investimet kapitale në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2025-2027; tabela 4.3 - të hyrat vetanake të komunës për vitet 2025-2027, janë pjesë e këtij vendimi, të bashkëngjitura në shtojcë.

7. Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesja e Kuvendit dhe i njëjti i dorëzohet Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për zbatim.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-pasi i falënderoj anëtarët e kuvendit që votuan për aprovimin e buxhetit të komunës, shprehu keqardhjen e tij për ata që e lëshuan mbledhjen, duke vlerësuar se nuk instruksion politikë që e detyron ta devijon besimin e votës qytetare dhe për këtë ai do të jetë besnik deri në përfundimin e mandatit të tij pavarësisht epilogut. Përveç tjerash ai informoj se pllaka përkujtimore në fshatin Stanoc i Epërm do të nderohet nga fondi për bashkëfinancim me qytetar dhe nuk ka pasur nevojë që i njëjti të futet në buxhet.

3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese, për periudhën janar – qershor 2024.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-duke ju referuar raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese, për periudhën janar – qershor 2024, ceku se ky raport më tepër i ngjason një informate nga ana e aktiviteteve që kanë zhvilluar drejtoritë komunale se sa një raporti

të mirëfilltë. Duke u bazuar në faqen 7 të raportit pyeti se si është bërë kontaktimi i materialeve higjienike dhe furnizim me ujë dhe pije vlera e kontratës për furnizim 450,000.00 €, ndërsa më tej është lidhur edhe një kontratë në vlerë 49,000.00 €. Më pas tek furnizimi me teknologji informative pyeti se deri ku ka shkuar procedura vlera e kontratës 100,000.00 €. Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve të zërimit në sallën e kuvendit, është dashur të përfundoj deri në qershor 2024, por as që ka filluar dhe shprehu dyshimin se ky projekt do të dështoj sikur edhe në të kaluarën. Tek kontrata për shërbime, marrja e veturave me qira vlera e kontratës 50,000.00, pyeti se çfarë është duke ndodhur me automjetet e komunës. Shërbimet konsulente për personat me nevoja të veçanta, ku nuk ka asistente për fëmijët me nevoja të veçanta, në ndërkohë çfarë planifikohet të bëhet me shumën e mjeteve financiare prej 100,000.00 €. Tek hartimi i planit komunal të veprimt për energji, krijimi dhe përmirësimi i kushteve përmes uljes së shpenzimeve vlera e kontratës 90,000.00€, çfarë mendohet të bëhet me këto mjete. Promovimi i agroturizmit, turizmit urban dhe trashëgimisë kulturore vlera 260,000.00 €. Hartimi i projekteve dyvjeçare. Ndërtimi i trotuareve në fshatin Sfaracak rr. "Lidhja e Lezhës" po ashtu edhe në fshatin Maxhunaj nuk kanë filluar fare. Ndërtimi i sheshit të Lirisë, pyeti kush e ka emëruar këtë shesh dhe ku gjendet ky shesh. Rehabilitimi i Qendrës Rezidenciale në Lumadh, nuk ka ndodhur ky rehabilitim por janë kaluar mjetet në blerjen e një veture për rezident. Ndërtimi i tribunave në stadiumin "Ferki Aliu" nuk ka përfunduar po ashtu edhe zhveshoret në stadium nuk kanë përfunduar. Rehabilitimi i dhomave për para-fillor Vushtrri, për çka është menduar.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit-tha se ky dokument nuk i ngjason aspak një raportit gjithëpërfshirës, kjo për faktin se vetëm kemi grumbullim të të dhënave, ndërsa strukturalisht nuk i ka konditat e një raportit sepse nuk kemi një qëllim nuk ka rekomandime për ato që thuhet dhe nuk është nxjerr ndonjë konkluzion. Tutje pyeti se çfarë po ndodh me kultivatorët që kanë pasur të shpërndahen dhe si janë raportet me TIKEN, ku thuhet se kjo organizatë i ka shkëputur raportet me Komunën e Vushtrrisë. Po ashtu pyeti rreth numrit të atyre që janë subvencionuar si për qumësht ashtu edhe për kafshët tjera shtëpiake (dele, dhi bollica). Më tej do të ndahen granet të vogla për subvencionim të frutave, kur do të ndodh një gjë e tillë. Marrëveshja e bashkëpunimit me Iber-lepencin për subvencionimin e ujitjes së tokës në vlerën 50%, sa fermer kanë përfituar në këtë proces. Më pas shtroj dhe pyeti se çfarë i duhet kredia Komunës së Vushtrrisë kur ajo mjetet e veta nuk i ka shpenzuar dhe milion euro kanë shkuar në suficit. Si shqetësuese paraqiti faktin e një kontrate për furnizim me mjete higjienike, pije dhe ushqim vlera 450,000.00 € pyet se ku kanë shkuar gjithë këto mjete.

53966	NDERTIMI I OBJEKTIT PER LABORATOR NE FSHATIN LUMEMADH	3,042.00	0.00	3,042.00	-
54007	TEKNOLOGJI INFORMATIVE PER QKMF- VUSHTRRI	20,000.00	0.00	20,000.00	-
54013	AUTOMJET TERENI PER SHKPSH-VUSHTRRI	30,000.00	0.00	30,000.00	-
54706	RREGULLIMI I SPORTELUT NE QMF- PANTINE DHE QKMF NE OBJEKTIN	7,000.00	0.00	7,000.00	-
54707	APARAT PER HEKJROSJE ROLE DHE PAJISJE TJERA	16,000.00	0.00	16,000.00	-
54708	KALLIDA OILER NE OBJEKTIN E QMF-1 VUSHTRRI	77,000.00	0.00	77,000.00	-
54709	KOMBI PER HEMODALIZE SKPSH-VUSHTRRI	39,000.00	38,850.00	150.00	99.62
54710	REHABILITIMI I OBJEKTEVE SHENDETESORE DHE RRETHOJAVE PER QKV	70,000.00	69,509.85	490.15	99.30
54711	INVENTOR PER LABORATOR PER QKMF- VUSHTRRI	10,000.00	0.00	10,000.00	-

75616	SHERBIMET SOCIALE - VUSHTRRI	11,069.03	8,000.00	3,069.03	72.27
53626	RREGULLIMI I NYJEVE SANITARE PËR OPS - VUSHTRRI	69.03	0.00	69.03	-
53629	BLERJA E GJENERATORIT PËR OPS VUSHTRRI	1,000.00	0.00	1,000.00	-
54950	REHABILITIMI I OBJEKTIT TE OPS- VUSHTRRI	10,000.00	8,000.00	2,000.00	80.00
75617	SHERBIMET REZIDENCIALE - VUSHTRRI	16,136.26	0.00	16,136.26	-
53625	BLERJA E VETURES PËR SHERBIMET REZIDENCIALE	1,136.26	0.00	1,136.26	-
54954	REHABILITIMI I OBJEKTIT TE QR - VUSHTRRI	15,000.00	0.00	15,000.00	-
85024	SHERBIMET KULTURORE - VUSHTRRI	257,830.77	20,000.00	237,830.77	7.76
51007	RENOVIMI I PALESTRES „JETON TERRESTENA“	0.75	0.00	0.75	-
52299	BLERJA E MONITORIT LED ME PERMASA 3X3 PËR SKENEN E SALES NE	695.00	0.00	695.00	-
52825	RESTAURIMI DHE KONSERVIMI I OBJEKTIT "ARKIVI I VJETER" ISH QENDRES	30,000.00	0.00	30,000.00	-
52877	NDERTIMI I NJE SKULPTURE ME KARAKTER ARTISTIK (PARA QENDRES	130.00	0.00	130.00	-
53632	RIKONSTRUKTIMI I MUZEUT "MAHMUT AGE GJINOLL"	2,000.00	0.00	2,000.00	-
53991	RENOVIMI I PALESTRES "JETON TERRESTENA"	5.00	0.00	5.00	-
54727	RREGULLIMI I MEMORIALEVE NE GLAVOTIN, REZNIK, BEÇIO, DUBOC	35,000.00	0.00	35,000.00	-
54731	REHABILITIMI I PLATOSE NE KALANE E QYTETIT	30,000.00	20,000.00	10,000.00	66.67
54735	NDERTIMI/RIKONSTRUKTIMI I FUSHAVE SPORTIVE MAXHUNAJ, LUMAJADH,	100,000.00	0.00	100,000.00	-
54743	NDERTIMI I TRIBUNAVE, DHE OBJEKTEVE PERÇELLESE NE SAJUMIN	60,000.00	0.00	60,000.00	-

92060	NGRITJA E PERFORMANCES 2019	0.02	0.00	0.02	-
92670	ARSIMI PARAFILLOR ÇERDHEË - VUSHTERRI	60,345.55	44,506.71	15,838.84	73.75
53069	NDERTIMI I DEPOSE PËR FOLEJA III VUSHTERRI	152.34	0.00	152.34	-
53072	NDERTIMI I DEPOSE PËR FOLEJA II	193.21	0.00	193.21	-
54885	REHABILITIMI I ÇERDHEË , FOLEJA- VUSHTERRI	60,000.00	44,506.71	15,493.29	74.18
93690	ARSIMI FILLOR - VUSHTERRI	710,380.58	425,714.69	284,665.89	59.93
51854	Ndërtimi i tualeteve ne SHMU , Emin Duraku"	222.39	0.00	222.39	-
51866	Meremetimi i SHMU ,Enver Hadar" - Smekonicë	350.00	0.00	350.00	-
51869	Meremetimi i SHFMU "Mihalig"	550.00	0.00	550.00	-
51870	Meremetimi i SHFMU "Rexhep Musa"	532.00	0.00	532.00	-
52463	RENOVIMI I SHFMU "MIGJENI" STANOC LAGJA CAKAJ	17,910.00	0.00	17,910.00	-
52464	RENOVIMI I SHFMU "LUMINI SURDULLI" SAMADREXHE	3,980.95	0.00	3,980.95	-
52465	RENOVIMI SHFMU "ENVER HADRI" SMREKONICË	3,525.78	0.00	3,525.78	-
52779	NDERTIMI I PLATOS PËR SHFMU "EMIN DURAKU "	4,101.50	0.00	4,101.50	-
52781	NDERTIMI I DEPOS NE SHFMU "ADEM VOCA "PASOMIE	147.70	0.00	147.70	-
52910	NDERTIMI I DEPOSE PER SHFMU "MIGJENI" LAGJA CAKAJ	147.70	0.00	147.70	-
52913	NDERTIMI I DEPOSE PËR SHFMU "MIGJENI" STANOC	363.00	0.00	363.00	-
52961	NDERTIMI I DEPOSE PËR SHFMU "ENVER HADRI" SMREKONICË	279.00	0.00	279.00	-

52967	NDERTIMI DEPOSE PER SHF "ALI KELMENDI" VUSHTRI	773.80	0.00	773.80	-
52995	NDERTIMI DEPOSE PER SHFMU "7 MARS" BUKOSH	204.70	0.00	204.70	-
53000	NDERTIMI DEPOSE PER SHFMU "AVDYL FRASHERI" DRUAR	185.70	0.00	185.70	-
53024	NDERTIMI SHFMU "MUSTAF VENHARI"	150,000.00	150,000.00	0.00	100.00
53032	RENOVIMI SHFMU "LATIF BERISHA" DOBERLLUKE	5,000.00	3,143.60	1,856.40	62.87
53051	RENOVIMI SHFMU "LIRIA " STROC GLLAVOTIN	3,099.54	0.00	3,099.54	-
53052	RENOVIMI SHFMU REZNIK	640.00	0.00	640.00	-
53053	RENOVIMI SHFMU -MIHALIQ	2,000.00	1,262.50	737.50	63.13
53054	RENOVIMI SHFMU "RILINDJA" MAXUNAJ	3,506.72	0.00	3,506.72	-
53055	RENOVIMI SHF "ALI KELMENDI"	925.55	0.00	925.55	-
53533	NDERTIMI PLATOS PER SHFMU "28 NENTORI" VERNICE	3,469.00	0.00	3,469.00	-
53713	NDERTIMI DEPOSE PER SHFMU "MARTIRET" REZNIK	234.70	0.00	234.70	-
53968	MEREMETIMI SHMU - 1 VUSHTRI	3,230.85	0.00	3,230.85	-
54749	REHABILITIMI OSORRIT NE SHKOLLEN SHMU II	30,000.00	0.00	30,000.00	-
54756	REHABILITIMI DHOMAVE TE PARAFILLOREVE VUSHTRI	60,000.00	26,924.80	33,075.20	44.87
54805	NDERTIMI DEPOSE PER SHKOLLA NE PESTOVE "RILINDJA" SAHRI	70,000.00	20,000.00	50,000.00	28.57
54811	REHABILITIMI ARKIVES NE SHF ALI KELMENDI VUSHTRI	15,000.00	0.00	15,000.00	-
54821	REHABILITIMI SHFMU MUSTAFE SHYTI OSHLAN	50,000.00	0.00	50,000.00	-

54890 REHABILITIMI I SHFMU „ENVER HADRI“ SMREKONICE	80.000.00	24.383.79	55.616.21	30.48
55026 NDERTIMI I SHKOLLËS FILLORE "MUSTAFA VENHARI"- VUSHTERRI	200.000.00	200.000.00	0.00	100.00
94890 ARSIMI I MËSËM - VUSHTERRI	205,683.29	8,175.39	197,507.90	3.97
51874 Pajisje për praktikë profesionale SHMP "Bahri Haxha"	3.337.08	0.00	3.337.08	-
51875 Kaldaja për ngrohtë qendrore "Lutfi Musiqi"SHMU II	10.852.16	0.00	10.852.16	-
52448 MEREMETIMI I GJIMNAZIT "EQREM ÇABEJ"	520.00	0.00	520.00	-
52462 MEREMETIMI I SHMT "LUTFI MUSIQI" VUSHTERRI	5.000.00	0.00	5.000.00	-
52716 TEKNOLOGJI INFORMATIVE SHMT "LUTFI MUSIQI"	8.660.00	0.00	8.660.00	-
52758 TEKNOLOGJI INFORMATIVE GJIMNAZIT "EQREM ÇABEJ" VUSHTERRI	5.021.00	0.00	5.021.00	-
52768 TEKNOLOGJI INFORMATIVE SHMP :BAHRI HAXHA"	1.567.00	0.00	1.567.00	-
52775 BLERJA E PAJISJEVE TË TI (TELEVIZOR) " BAHRI HAXHA"	3.000.00	0.00	3.000.00	-
53688 BLERJA E PAJISJEVE PËR PRAKTIKË SHMT "LUTFI MUSIQI"	5.000.00	0.00	5.000.00	-
53970 NDE PUNËTORISE DHE KABINETEVE NE SHMT LUTFI MUSIQI VUSHTERRI:	16,992.00	3,175.39	13,816.61	18.69
54912 NDERTIMI I PUNËTORISE PËR AUTOMEKANIK DHE METALPUNËS NE SHM	45.000.00	5.000.00	40,000.00	11.11
54967 RREGULLIMI I PLATOS SE LAPIDARIT ,LUTFI MUSIQI"	5.000.00	0.00	5.000.00	-
54972 NDERTIMI I POLIGONIT NE SHMT LUTFI MUSIQI	30.000.00	0.00	30,000.00	-
54978 REHABILITIMI I TUALETEVE NE SHMP BAHRI HAXHA VUSHTERRI	35.000.00	0.00	35,000.00	-
54990 REHABILITIMI I FUSHES SPORTIVE NE SHMP BAHRI HAXHA	20.000.00	0.00	20,000.00	-

VUSHTRRI	54992 NDERTIMI I KLASIVE VERORE NE GJIMNAZIN EQREM ÇABEU	10,000.00	0.00	10,000.00	-
	93222 RREGULLIMI I SHKOLLES BAHRI HAXHA	577.05	0.00	577.05	-
	95104 FURNIZ MJEETE PER PUNTOR:SALDATOR-AXHUSTATOREVE	157.00	0.00	157.00	-
Totali I Përgjithshëm		8,176,845.45	4,134,142.33	4,042,703.12	50.56



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri

Për: KPF dhe Kuvendin e Komunës të Vushtrrisë

Propozues dhe hartues: Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit

Tema: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, si dhe nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi 4 i Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë: _____ 2024 merr këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E DRAFT-PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT PËR VITIN 2025

1. Me këtë vendim formohet komisioni për hartimin e Draft-planit të punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024, në përbërjen si në vijim:

- 1.1 **Melihate Basholli-Latifi**, kryesuese e kuvendit;
- 1.2 _____ anëtar i kuvendit;
- 1.3 _____ anëtar i kuvendit;
- 1.4 _____ anëtar i kuvendit;
- 1.5 _____ anëtar i kuvendit;

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, duhet të takohet brenda një afati të arsyeshëm dhe të hartojë draftin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2025, dhe të njëjtin duhet t'ia propozojë Kuvendit të komunës për aprovim në mbledhjen e muajit dhjetor 2024.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke i përmbushur obligimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e vetëqeverisjes lokale, si dhe me qëllim të përgatitjes së Planit të Punës të Kuvendit për vitin 2025, ofron para kuvendit Propozim-vendimin për formimin e komisionit për hartim të Planit të Punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025.

Plani i Punës i Kuvendit është një dokument vjetor, mjaft i rëndësishëm për kuvendin në adresimin e punëve dhe aktiviteteve të kuvendit, duke harmonizuar temat me kryetarin e komunës, të cilat do të jenë objekt shqyrtimi dhe do t'i nënshtrohen aprovimit nga kuvendi.



Me qëllim të lehtësimit të punëve dhe aktiviteteve të kuvendit, si dhe duke marrë për bazë hartimin e një plani sa më gjithëpërfshirës, i propozojmë kuvendit të komunës që ta aprovojë këtë propozim-vendim si në dispozitiv të tij.



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

Drejtoria për Shërbime Publike

Datë/a:	07.10.2024
Për:	Kuvendin Komunal Vushtrri
Përmes:	Kryetari i Komunës z. Ferit Idrizi 
Nga:	Drejtori i Drejtorisë Benjamin Shala 
Tema:	Informatë lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm në Komunën e Vushtrrisë

Drejtoria për Shërbime Publike, është organ i Kuvendit të Komunës e cila zbaton Ligjet, Rregulloret, me të cilat rregullohen Shërbimet Publike, prandaj mbështetur në programin e punës së Kuvendit, ka përgatitur këtë informatë lidhur me shërbimet publike si; furnizimi me ujë nga rrjeti i ujësjellësit dhe pastrimi i ambientit nga mbeturinat.

Të nderuar Deputetë,

Drejtoria për Shërbime Publike bënë rregullimin e qytetit dhe mbrojtjen e ambientit, bënë mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale të asfaltuara dhe të rendit të katërt, rregullimin e qarkullimit të komunikacionit, sinjalizimin horizontal dhe vertikal, parkingjet, transportin lokal, shërbimin me automerimangë, përcjell largimin e ujërave atmosferike nga sipërfaqet publike, mbikëqyrë punën e lëmisë së furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të zeza, menaxhon me procedurat e bartjes dhe deponimit të hedhurinave, pastrimin dhe larjen e rrugëve, shesheve dhe sipërfaqeve publike, mirëmbajtjen e shtratit të lumenjve, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e varrezave, parqeve dhe gjelbërimit të qytetit, mbikëqyrë dhe menaxhon punën e autoparkut të Kuvendit Komunal, etj.

Furnizimi me ujë të pijshëm

Gjatë këtij viti kemi qenë të orientuar në vazhdimin e kyçjeve të ekonomive familjare në rrjetin e ujësjellësit në të gjitha fshatrat e komunës, projekt ky i kontraktuar dhe në përfundim e sipër. Në këtë projekt kanë vazhduar të riparohen rrjeti shpërndarës dhe kyçjet e ekonomive familjare në fshatrat: Ropicë, Vilanc, Samadrexhë, Sfaraqak, Smrekonicë.

Në fshatin Dumnicë është bërë shtrirja e gypit i cili furnizon me ujë rezervarin i cili pritet të furnizoj me ujë të pijshëm Dumnicen e Poshtme dhe Dumnicen e Llugës. Në fshatin Smrekonicë është ndërtuar dhoma e pompave është riparuar pompa ekzistuese si dhe është instaluar pompa e re të cilat po furnizojnë me ujë të gjithë fshatin, njëjtë është vepruar edhe në fshatin Sfaraqak ndërsa në Maxhunaj është instaluar një pompë e re si pompa ndihmëse për stacionin e pompave

në fshatin Ropicë ku është duke u furnizuar me ujë të pijshëm fshati Ropic, Vilanc si dhe një pjesë e madhe e fshatit Samadrexhë gjithashtu është duku u punuar në riparimin e gypit shpërndarës pasi që i njëjti është shumë i dëmtuar .

Sipas të dhënave nga menaxheri i njësisë operative të kompanisë së ujësjellësit regional KRU,,Mitrovica”, gjatë periudhës janar-shtator të këtij viti kemi këto të dhëna:

Raporti sipas shërbimeve dhe kategorisë së pronës

Nga:1/2024 - Deri:9/2024

Emri Kompanise	Kategoria e prones	Sherbimi	Numri kons.	Nr.Fatura ve	Çmimi pa TVSH	TVSH	Çmimi me TVSH	Sasia
KUR Mitrovica	AMVISNI	UJI	17240	151964	617587.14	49429.69	667016.83	1716138.56
		UJE Pa MATje	459	3908	29160	2327.2	31487.2	81013.38
		Total			646747.14	51756.89	698504.03	1797151.94
	BIZNESE	UJI	1004	8725	51384.03	4110.19	55494.22	95159.61
		UJE Pa MATje	12	108	174.96	14.04	189	324
		Total			51558.99	4124.23	55683.22	95483.61
	Institucione	UJI	118	1077	60034.5	4802.77	64837.27	172113
		UJE Pa MATje	3	27		0	0	1809
		Total			60034.5	4802.77	64837.27	173922
	Nderkombetar	UJI	1	9	46107.9	0	46107.9	85385
		Total			46107.9	0	46107.9	85385
	Total					804448.53	60683.89	865132.42

Raporti sipas shërbimeve dhe kategorisë së pronës

Nga:1/2024 - Deri:9/2024

Emri Kompanise	Kategoria e prones	Sherbimi	Numri kons.	Nr.Faturave	Çmimi pa TVSH	TVSH	Çmimi me TVSH	Sasia	
KUR Mitrovica	Amvisni	KANALIZIMI	9964	87926	89995.85	7192.99	97188.84	1000654.14	
		Kanalizim PA MATje	225	1941	3912.03	316.14	4228.17	43479.17	
		Total			93907.88	7509.13	101417.01	1044133.31	
	Biznese	KANALIZIMI	950	8303	16324.04	1309.44	17633.48	81624.61	
		Kanalizim PA MATje	13	117	68.4	5.7	74.1	342	
		Total			16392.44	1315.14	17707.58	81966.61	
	Institucione	KANALIZIMI	76	699	13969.8	1117.62	15087.42	71870	
		Kanalizim PA MATje	2	18	0	0	0	1800	
		Total			13969.8	1117.62	15087.42	73670	
	Total					124270.12	9941.89	134212.01	1199769.92





Republika e Kosovës



Komuna Vushtri

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

DATE	7 tetor 2024
REFERENCË	03/ /2024
PËR	<i>Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë</i>
PËRMES	z. Ferit Idrizi  Kryetar i Komunës
NGA	Izet Miftari  Drejtor i DKRS-së
TEMA	Informatë nëntëmuajore lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive duke përfshirë teatrin bibliotekën dhe muzeun

Duke iu referuar Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024, me nr. 290/33, të datës 28.12.2023, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, e Komunës së Vushtrrisë paraqet këtë:

INFORMATË NËNTËMUJORE LIDHUR ME ZHVILLIMIN DHE REALIZIMIN E AKTIVITETEVE KULTURORE, RINORE DHE SPORTIVE DUKE PËRFSHIRË TEATRIN, BIBLIOTEKËN DHE MUZEUN

Në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport veprojnë sektorë të ndryshëm, andaj edhe informatat lidhur me zhvillimin e aktiviteteve paraqitet sipas sektorëve. Në vazhdim paraqesim të dhëna mbi zhvillimin e aktiviteteve kulturore, sipas sektorëve të DKRS-së:

1. QENDRA E KULTURËS “HASAN PRISHTINA”

Duke iu referuar Planit e Punës për vitin 2024, në Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina" punët kanë rrjedhë sipas planit, duke realizuar në tërësi planin e punës, por duke e plotësuar atë edhe me aktivitete të reja shtesë, të cilat ndonëse nuk ishin paraparë në planin e punës, kanë dalë si rezultat i ideve të reja të stafit të drejtorisë sonë, apo edhe qytetarëve që janë marrë me aktivitete kulturore, por edhe institucionet tjera me të cilat kemi bashkëpunuar gjatë këtij viti.

Stafi i Qendrës për Kulturë “Hasan Prishtina” gjatë këtij viti ka mbështetur apo ka organizuar të gjitha aktivitetet kulturore që janë organizuar nga institucionet komunale. Po ashtu, ka ndihmuar në organizimin e aktiviteteve të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe aktiviteteve të ndryshme në të cilat është kërkuar ndihma jonë, qoftë nga organizatat rinore, grupet e intelektualëve apo shkollat e komunës së Vushtrrisë. Ne, në vazhdimësi kemi mbështetur, por edhe kemi marrë pjesë në organizimin e shumë takimeve letrare, si promovime të librave të ndryshëm në territorin e komunës sonë, kryesisht të autorëve vushtrrias. Gjithashtu, janë mbështetur edhe shumë artistë për organizimin e ekspozitave të tyre, në Galerinë e Arteve në Qendrën e Kulturës, si dhe aktorëve për realizimin e shfaqjeve që janë dhënë në Teatrin e Qytetit "Adem Mikullovcit". Një punëtor i QK “Hasan Prishtina” mban në vazhdimësi të hapur dhe përkujdeset për Kalanë e Qytetit. Vlen të përmendet se në këtë vit kemi qenë të angazhuar edhe në organizimin e disa akademive përkujtimore, për nder të disa personaliteteve të rëndësishme nga Vushtrria.

Në aktivitetet kulturore që janë organizuar nga ana jonë janë përfshirë në organizime edhe sektorët e tjerë të DKRS-së, çdoherë që ka qenë e nevojshme.

Ndër aktivitetet kulturore që kemi organizuar apo që kemi marrë pjesë në organizim veçojmë:

- Organizimi i ceremonisë për shpalljen e Sportistëve të vitit 2023;
- Akademi përkujtimore dhe zbulimi i lapidarit për dëshmorin e kombit Mehdi Haziri;
- Mbështetja në organizimin e Akademisë për Mehmet Konjuhun. Me këtë rast është organizuar Konferencë Shkencore kushtuar ngjarjes në fjalë, të cilën e ka organizuar Universiteti i Prishtinës në bashkëpunim me komunën e Vushtrrisë;
- Përgatitja e kushteve në Qendrën e Kulturës për shfaqje nga Teatri i Mitrovicës (pasi që objekti i teatrit në Mitrovicë ishte në rinovim);
- Akademi Solemne për nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës;
- Ekspozitë e piktorit vushtrrias Ismet Bylykemi;
- Përrurimi i librit “Rrezet e lirisë”, i autorit Gani Lahu;
- Organizimi i aktiviteteve për Epopenë e UÇK-së “Nata e zjarreve” me ushtarë të UÇK-së në fshatin Stroc;
- Përgatitja e kushteve për organizimin e “Ditës së Mësuesit”;
- Përrurimi i librit “Aventurat në Mbretërinë Magjike” i autores vushtrriase Alejna Selimi;
- Aktivitet me fëmijët me Sindrom Down mbështetur nga Instituti Younus Emre;

- Aktivitet i organizuar nga komuniteti turk dhe i mbështetur nga ana jonë;
- Organizimi i një koncerti në Selanik të Greqisë, në bashkëpunim me shoqatën “Jeta” në Greqi;
- Akademi përkujtimore dhe film dokumentar për dëshmorin Shemsi Istrefi;
- Koncert i përbashkët me austriakë, organizuar përmes mërgimtarëve shqiptarë në Austri;
- Përgatitja e kushteve për ceremoninë e nënshkrimit të Kontratës Sociale, organizuar nga USAID;
- Akademi Përkujtimore "Studimja '99";
- Akademi Përkujtimore për nder të përkujtimit të masakrës së 22 Majit në Vushtrri;
- Akademi Përkujtimore për Masakrën mbi Familjes Gërzhaliu;
- Aktivitete dhe koncert për fëmijë për nder të Ditës së Fëmijëve - 1 Qershori 2022;
- Përrurimi i librit “ Monografi për Tafil Morinës”, i autorit Halil Mulaku;
- Tryezë shkencore me rastin e 146 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit dhe 25 vjetorit të çlirimit të Kosovës. Kjo tryezë është mbajtur më 10 qershor 2024. Pjesë e panelit kanë qenë: Prof.asoc.dr.Mentor Hasani, Por.asoc.dr.Skënder Lutfiu, Dr.sc.Izet Miftari dhe Mas.asist. Oktaj Hasani;
- Akademi Solemne për nder të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë – 17 qershor 2022;
- Ceremonia e diplomimit të gjimnazistëve vushtrrias;
- Organizimin e 112 – vjetorit të ngritjes së flamurit në Vesekoc dhe Kuvendit të Kurillovës.
- Akademi Përkujtimore për 100 – vjetorin e rezistencës në Arbërinë e Vogël. Në këtë kuadër është mbajtur edhe Konferencë Shkencore, mbështetur nga Universiteti I Prishtinës, dhe është hapur Ekspozitë me forografi e dokumente për Azem e Shote Galicën.
- Koncerte në kuadër të manifestimit “Ditët e Diasporës”.
- Përkujtimi i organizimit të mësimin paralel në fshatin Skromë;
- Akademi Përkujtimore për 1 Shtatorin – Ditën e Dëshmorëve të Kombit – Komuna e Vushtrrisë;
- Përrurimi i librit “Bunjakët nëpër shekuj”, i autorit Jakup Krasniqi;
- Përrurimit të librit” Harrova të jetoj” i autores Ymrije Beqiri;
- Përrurimi i librit “ Sad Nallbani”, i autores Sevëme Fetiqi;
- Janë kryer të gjitha përgatitjet për organizimin e Festivalit “Takimet e Poeteshave Shqiptare”.

2. BIBLIOTEKA “NAIM FRASHËRI”

Gjatë periudhës janar-shkurt 2024, në sektorin e bibliotekës komunale “Naim Frashëri” Vushtrri, janë realizuar detyra dhe aktivitetet të punës që lidhen me sektorin e bibliotekës, por edhe një mori aktivitete, si akademi të ndryshme të cilat u organizuan nga DKRS-ja, e ku kontribuoi edhe sektori i bibliotekës, duke ndihmuar në organizimin e aktivitetet të ndryshme.

Aktivitetet e punës në sektorin e bibliotekës së qytetit: “Naim Frashëri’ Vushtrri:

Libra të përpunuara gjatë periudhës janar-shtator 2024

Përpunuar	1775
Vulosje	5870
Signim	2460
Vendosje e tiketave	1665
Inventarizim	2380
Regjistrim në kompjuter	860

Libra të huazuara në sektorin e fëmijëve	3729
Libra të huazuara në sektorin e të rriturve	2785
Sallën e leximit e shfrytëzuan	671
lexues të ri të regjistruar gjithsej	107

Aktivitetet e zhvilluara në sektorin e bibliotekës komunale "Naim Frashëri" Vushtrri, gjatë periudhës janar-shtator 2024:

- Akademi përkujtimore për dëshmorin e UÇK, Mehdi Haziri, nga fshati Druar.
- Akademi Përkujtimore me rastin e 100 vjetorit të rezistencës në zonën e lirë në Zagori dhe masakrës ndaj civilëve shqiptarë aty, të kryer nga regjimi serb i kohës;
- Përrurimi i librit "Harrova të jetoj" i autores Ymrije Beqiri;
- Intervistë dhënë RTK-së nga drejtori i DKRS, z. Izet Miftari dhe udhëheqësja e bibliotekës znj. Kadrije Meniqi,
- Promovimi i librit "Bunjakët nëpër shekuj", i profesor Jakup Krasniqit;
- Promovimi i librit "Sad Nallbani", të autores Sevëme Fetiçi;
- Akademi solemne me rastin e 1 Shtatorit – Dita e Dëshmorëve të komunës së Vushtrrisë;

Dhurues të librave:

Bibliotekës së qytetit, gjatë kësaj periudhe iu dhuruan 509 libra të ndryshëm.

Vizitat e delegacioneve të ndryshme dhe nxënësve të shkollave të komunës sonë në bibliotekën e qytetit.

Bibliotekën e qytetit gjatë periudhës janar-shtator 2024 e vizituan personalitete të ndryshme, si, poet, intelektualë, mërgimtarë, publicistë, veteranë të arsimit, drejtorë të institucioneve, të bizneseve, qytetarë dhe nxënës të shkollave.

3. MUZEU HISTORIK – ETNOGRAFIK

Gjatë periudhës nëntëmuajore të vitit 2024 muzeu organizoi aktivitete të cilat qëllimin kryesor kishin promovimin, edukimin dhe vetëdijesimin e gjeneratave të reja përmes komunikimit muzcor.

Disa nga aktivitetet e realizuara:

Vizita në shkollat e zonave rurale të Komunës së Vushtrrisë për qëllim të hulumtimit të pasurive muzeore, por edhe për të ligjëruar në kuadër të procesit mësimor tek lënda shoqëria dhe mjedisi.

Rëndësi të veçantë i është kushtuar pritjes të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme në realizimin e vizitave edukative e mësimore në Muzeun e Vushtrrisë / në monumentin “Mahmut agë Gjinolli”, si dhe në monumentet e trashëgimisë kulturore në Vushtri.

Disa nga aktivitetet e organizuara për të shënuar datat e rëndësishme kulturore janë:

- Përvjetori i 19-të i themelimit të Muzeut të Vushtrrisë;
- Dita Ndërkombëtare e Muzeve;
- Dita Ndërkombëtare e Trashëgimisë Kulturore;
- 1 qershorin - Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve;
- Dita e Evropës;

Gjithashtu, stafi i muzeut ishte pjesë edhe e aktiviteteve të shumta kalendarike të organizuara në kuadër të DKRS-së.

4. SEKTORI I RINISË

Takime pune dhe informues me përfaqësuesit e OJQ- ve rinore.

Planifikimi dhe hartimi i projekt propozimeve dha janë dërguar për mbështetje në MKRS dhe USAID-ATRC, OSCE dhe organizata tjera.

Takime pune dhe bashkëpunim me OSCE, ku janë plotësuar disa pyetësor që janë dërguar nga ta edhe njëherë OSCE ka shpreh gatishmëri që të bashkëpunojë në aktivitete të ndryshme në fushat të cilat mund të na ndihmojë OSCE-ja.

Qendra Rinore “Hareja” ka mbajtur trajnime për Rrobaqepësi dhe Modë për të gra dhe vajza të grup moshave të ndryshme, në fund të këtyre trajnimeve pjesëmarrësve në trajnime u janë ndarë edhe certifikata për ndjekjen e trajnimeve.

Organizata Rinore “Access” në bashkëpunim me sektorin e rinisë dhe Departamentin e Rinisë – MKRS ka planifikuar që të organizojnë trajnime për të rinjtë në komunën e Vushtrrisë, është hartuar projekt propozimi dhe do të dërgohet për financim.

Është realizuar projekti “Komuna për të Rinjtë” ky projekt është realizuar nga Komuna e Vushtrrisë në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Bankës Botërore si dhe organizatës facilituese CDF. Ky projekt ka pasur një ndikim të mirë për zhvillimin e aktiviteteve rinore, pasi që shumica totale për mbështetjen e të rinjve në total ka arritur vlerën 250,000.00 dollar amerikan.

Trajnime për shkathtësi të buta, kurse për kompjuter, kurse për gjuhë të huaja, kurse për matematikë, të mbajtura nga Qendra Rinore “Hareja” e cila është licencuar në fund të vitit të kaluar.

5. SEKTORI I SPORTIT

Në kuadër të aktiviteteve “Ditët e Diasporës” (korrik 2024) është organizuar turneu në basketboll (Streetball) me katër ekipe pjesëmarrëse.

Është organizuar turneu tradicional memorial në hendboll “Jeton Tërstena – TOTA”, më 28 gusht 2024, ku pjesëmarrëse në këtë turne ishte edhe ekipi nga Qipro KKTC. Po ashtu turneun e nderuan me pjesëmarrje edhe ekipet më të mira të Kosovës si: Besa Famgas nga Peja dhe Vjosa nga Komuna e Shtimes.

-ARRITJET NË KLUBET SENIOR

- 1.KLUBI FUTBOLLIT “VUSHTRRIA “ në bashkëpunim të ngushtë me kryetarin e Komunës ka bërë një organizim shumë të mirë që të bëhet anëtar i super ligës për sezonin e ardhshme.
- 2.KLUBI HENBOLLIT “VUSHTRRIA” (M) ka arritur që të jetë në super ligën e Hendbollit Kosovar, edicionin e ri garues do të jetë pjesëmarrëse edhe në garat ndërkombëtare.
- 3.KLUBI HENBOLLIT “VUSHTRRIA”(F) ka arritur që të jetë një ndër ekipet me të mira në super ligën e Hendbollit Kosovar ka arritur që të jetë në gjysmëfinale të Kupës së Kosovës.
- 4.KLUBI HENBOLLIT “SAMADREXHA” (M) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka ruajtur statutin e Ligës së Parë.
- 5.KLUBI HENBOLLIT “ SAMADREXHA” (F) ka garuar në Superligë, dhe ka ruajtur statutin e Super ligës, dhe me rezultatet e treguara ka arritur që të jetë pjesëmarrëse në garat ndërkombëtare.
- 6.KLUBI BASKETBOLLIT “VUSHTRRIA” (M) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka ruajtur statutin e Ligës së Parë duke u renditur e dytë (2).
- 7.KLUBI BASKETBOLLIT “VUSHTRRIA BASKET” (F) ka garuar në Ligën e Parë dhe ka arritur që të jetë në vendin e tretë.
- 8.KLUBI VOLEJBOLLIT “ASVUSHTRRIA” (M) ka garuar në Super ligë, dhe ka ruajtur statutin e Super ligës,
- 9.KLUBI VOLEJBOLLIT “AS VUSHTRRIA” (F) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka arritur që të jetë në vendin e parë në Ligen e Parë Lindje.

10.KLUBI VOLEJBOLLIT “VUSHTRRIA” (F) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka arritur që të jetë në vendin e parë dhe të bëhet pjesë e ekipeve të super ligës së Kosovës në Volejball

11.KLUBI I FUTSALLIT FC “VUSHTRRIA” ka garuar në Ligën e parë, dhe ka arritur që të ruaj statutin në ligën e parë duke u renditur e dyta (2) në edicionin garues 2022/2023.

-KLUBET E KATEGORIVE TË REJA

1.KLUBI FUTBOLLIT “ VUSHTRRIA “ Kampion U 18 , Liga Regjionale.

2. KLUBI FUTBOLLIT “ VUSHTRRIA” Kampion U 17 , Liga Regjionale.

3. KLUBI FUTBOLLIT “EL CLASICO “ Fitues i Kupës U 17 , Liga Regjionale .

4. KLUBI FUTBOLLIT “ FORCA “ Vendi i Dytë (2) , Liga Regjionale.

5. KLUBI VOLEJBOLLIT “ AS VUSHTRRIA “ Finalist , U 18 , U 16

6. ARKIVI HISTORIK

Gjatë periudhës nëntë mujore të këtij viti në Arkivin e qytetit nuk janë zhvilluar aktivitete kulturore, përveç vizitave reciproke në mes të komunës sonë dhe komunës së Vaxjo – Suedi, të cilat kanë për qëllim administrimin dhe digjitalizimin e dokumenteve arkivore. Sa i përket aktiviteteve kulturore zyrtarët e arkivit kanë qenë të përfshirë në të gjitha aktivitetet kulturore që janë organizuar nga DKRS – ja.

7. TEATRI I QYTETIT "ADEM MIKULLOVCI"

Në bazë të kalendarit vjetor të aktiviteteve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, në teatrin e qytetit në Vushtrri ka filluar të realizojë projektin me të rinjtë nëpër shkolla me temën: “Teatri, rinia dhe edukimi”.

Teatri i Qytetit “Adem Mikullovcit”, përmes këtij aktiviteti ofron një platformë për shfaqjen e aftësive artistike të nxënësve, duke përfshirë aktrimin, regjinë dhe skenografinë. Për më tepër, kjo ndihmon në ndërtimin e vetëbesimit dhe aftësive të komunikimit të nxënësve, duke i përgatitur ata për të ardhmen.

Çdo i ri/e re, që ka aftësi për aktrim, regji, skenografi mund të paraqitet në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport - Sektori i Teatrit, për informata shtesë.

Më 15 dhe 16 korrik 2024, në kuadër të manifestimit 100 vjetori të rezistencës së Azem dhe Shote Galica Teatri i qytetit ishte i përfshirë gjerësisht në organizimin e këtij manifestimi.

Tani me teatrin e të rinjve kemi filluar realizimin e komedisë “Burri Burrë” tekst i Kristo Floqit që ne presim që në muajin nëntor të jetë si premierë. Provat kanë filluar.

Për nder të turnirit tradicional “Jeton Terstena-Tota” ishim organizator të gjithë këtij turniri.

Për nder të 1 shtatorit ditës së dëshmorëve të kombit, teatri u angazhua me program artistik si dhe në realizimin e pjesës që është përgatitur për atë ditë xhirim.

8. TRASHËGIMIA KULTURORE.

Më datë 27 shkurt, një delegacion nga *Universiteti i Tubingenit të Gjermanisë*, të cilin e kryesonte *Prof. Dr. Harald Floss*, i shoqëruar nga arkeologu Luan Gashi nga Instituti Arkeologjik i Kosovës, të shoqëruar nga zyrtari për kulturë, z.Burim Rexhepi, ishin në teren, përkatësisht fshatin Samadrexhë te lokaliteti “Gomure” e që është hera e dytë, që ishte profesor Flossi dhe hera e tretë me IAK, me qëllim të hulumtimit në atë lokalitet për gjetje artefaktesh që i takojnë periudhës së paleolitit. Në bazë të gjetjeve materiale në atë lokalitet, ka shumë shpresë që artefaktet i takojnë periudhës së paleolitit.

Përveç fshatit Samadrexhë, është vizituar edhe fshatin Strofc. Aty profesor Floss përnjohu shpellën-hulumtoj “Guri i kishës” profesor Floss bashkë me studentet e tij nga Universiteti i Tubingenit, meqë rast kanë vërejtur disa vizatime primitive e që sipas tyre janë prehistorike, edhe pse, lokaliteti “Gjyteti i Strofcit” njihet për periudhën romake, por që, ajo shpellë ka të bëjë me para historinë e që në vazhdimësi është përdorur.

Prof. Arben Hajdarin nga Universiteti i Prishtinës dhe prof. Christophe Goddard nga **Universiteti i Parisit të Francës**, kanë rilexuar(ri-deshifruar) mbishkrimet romake qe gjenden në komunën e Vushtrisë, si; Dubovc, Banjskë dhe në kishën ortodokse “Shën Ilija” në Vushtrri (*aty është gjetur një altar që i takon periudhës romake, i fshehur dhe i kamufluar nga regjimi dhe kleri serb*).

Në bashkëpunim me QRTK-Mitrovicë, është punuar në futjen nën mbrojtje të dy shtëpive; “Kahriman Pasomës” në Vushtrri dhe “Selatin Gerxhaliut” në fshatin Studime e Ulët.

Ka filluar restaurimi dhe konservimi i objektit te ish Arkivit, faza e pare është kryer, deri me tani dhe ka hyrë nën mbulojë - çati (kulm).

Iu dërgohet:

- 1 x KPF-së dhe KK-së
- 1 x Kryetarit të Komunës
- 1 x Arkivit të DKRS-së

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRN

GE Nr. / Gr. 1573/24

Nr. i fq. / Br. st.

Data: / Datum 07.10.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr. 10. Tel. 038/200 42402. E-mail: ferit.idrizi@rks.gov.net

PËR/ZA/TO:	Kuvendin e Komunës
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Ferit Idrizi Kryetari i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Draft – Marrëveshje Bashkëpunimi

Të nderuar anëtarë/e të Kuvendit të Komunës,

Të bashkëngjitur keni Draft - Marrëveshjen e Bashkëpunimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe OJQ "Zëri i Romëve Ashkalive dhe Egjiptianëve" për realizim të projektit: "Ndërtimi i shtëpive për banim për komunitetin RAE si dhe revidimin e Planit Trevjeçarë të Banimit Social për Komunën e Vushtrrisë.

Draft-Marrëveshja është hartuar në bazë të kërkesës së OJQ në fjalë e cila ka shprehë gatishmërinë që të bashkëfinancoj këtë projekt me dyfishin e mjeteve të cilat do të i siguroj Komuna e Vushtrrisë.

Në shtojcë iu dërgojmë: Kërkesën e OJQ "Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve" për realizim të këtij projekti, konfirmimin e Drejtorisë për Urbanizëm që në parcelën e cekur në këtë marrëveshje është i lejuar ndërtimi dhe fleta poseduese për parcelën.

Me respekt,

324/12.09.201

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITRIN

#2 Nr. / Br. 1440/24

Nr. / Titull / Br. tit. _____

Data: / Datum, 22.08.2024

VUSHTRRI - VUÇITRIN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr.10, Tel.+383/38 2004240, E-mail: ferit.idrizi@rks.gov.net

PËR/ZA/TO:	Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
CC	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Ferit Idrizi Kryetar i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë e OJQ "VORAE" iu dërgohet

Të nderuar Drejtorë,

Të bashkëngjitur keni kërkesën e OJQ-së "VORAE" me seli në Prishtinë për caktim të lokacionit për ndërtim të 6-8 shtëpive për banim në fshatin Prelluzhë, për familje të komunitetit Rom Ashkali dhe Egjiptian. Ky projekt kërkohet të realizohet me financim të përbashkët të kësaj organizate joqeveritare dhe Komunës së Vushtrrisë.

Si pikënisje e këtij projekti duhet që Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të analizoj gjithanshëm kërkesën në fjalë për të shqyrtuar mundësitë ligjore për realizim të kësaj kërkesë që nënkupton nëse është i lejuar ndërtimi në parcelën e specifikuar në kërkesë apo duhet të gjendet ndonjë parcelë tjetër në pronësi të komunës në atë fshat ku lejohet ndërtimi. Në rast se nuk ka pengesa ligjore për realizim të këtij projekti në parcelën e identifikuar nga kjo OJQ, atëherë duhet të hartohet propozim vendimi për caktim të lokacionit për këtë projekt dhe procedohet për KPF dhe kuvend për shqyrtim dhe miratim.

Në rast të miratimit të kësaj kërkesë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa duhet që me planifikimin e buxhetit për v. 2025 të propozoj në kuvend mjetet financiare për bashkëfinancim në vlerën e përcaktuar në kërkesë.

Lidhur me veprimet që do t'i ndërmerri për sa i përket kërkesës për këtë projekt kërkoj që të më informoni me shkrim brenda një afati sa më të shkurtër.

Shtojcë: Kërkesa e OJQ-së datë 19.08.2024



DATE/A	12.09.2024
Ref:	08Nr.360
PËR/ZA/TO:	Kryetari të Komunës Z .Ferit Idrizi
PËRMES/PREKO/THROUGH NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtja të Mjedisit U.D. Drejtori i Drejtorisë, Nexhat Merovci
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje me kërkesë



I nderuar,

Pas pranimit të kërkesës me të cilën keni kërkuar se për parcelën të cilën kanë kërkuar OJQ-Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve me përfaqësuese Violeta Thaqi e cila ka të bëjë me ndërtimin e shtëpive në fsh.Prelluzhë , Komuna Vushtrri në parcelën kadastrale me nr.P-70202053-00366-1, me sipërfaqe prej 25436m² se a lejohet ndërtimi i këtyre shtëpive bazuar në PZHK-në .

Andaj ne në konsultim me PZHK-në dhe Drejtorin për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ju njoftojmë se bazuar në PZHK-se parcela në fjalë gjendet brenda PZHK-se dhe ka këtë destinim 'Zonë Urbane e qendrës sekondare, ndërtim i lejuar vetëm përbrenda kufirit pra lejohet ndërtimi.

Me respekt!



Republika e Kosovës

Republica Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202053-00366-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

Komuna / Opština / Municipality:

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

Certificate draft

13.09.2024 - 14:33

VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI

Preluzhë / Preluzhë / Preluzhë

VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përkthim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70202053-00366-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena / Imovina / Socially owned Land		25436			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
SELISHTA				

A.2 LLOJTI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta korisçenja parcelë Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno korisçenja parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet Klasse Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area
1	Bujqësore/Pojiprivredno/Agriculture	Kullosar/Pashnjac/pasture	Kullosë E Klasës 2/Pashnjak 2 Klasse/2nd Class Pasture	25436

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Liceni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Poseçim individual / Indivudana Drzavina / Single possessor	Komuna e Vushtrisë	600535001	VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI /		AHMET KRASNIQI	1/1		



DRAFT - MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur në mes:

- Organizatës Jo-Qeveritare “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve” përfaqësuar nga **z. Isak Skenderi**, Drejtor Ekzekutiv, me numër të regjistrimit 5113364-1, me adresë në rrugën Rr. "Ali Pashë Tepelena", Aktash, 10000, Prishtinë, si bartës i konzorciumit të organizatave në projektin “Drejtësia Sociale”,
dhe
- Komunës së Vushtrrisë, përfaqësuar nga **z. Ferit Idrizi**, Kryetari i Komunës, Sheshi “Ahmet Krasniqi nr. 10 Vushtrri (me tej ne tekst ‘Komuna’)

Neni 1 Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshje është përcaktimi i bashkëpunimit në mes Komunës së Vushtrrisë dhe OJQ “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve” për riorganizimin dhe disegregimin etnik të vendbanimit në fshatin Prilluzhë për të siguruar zgjidhje më afatgjate të banimit të qëndrueshem dhe mundësi për zhvillim socio-ekonomike për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, dhe jo vetëm.

Neni 2 Qëllimet specifike

- 2.1 Revidivimi i Planit Tre Vjecar të Banimit Social në bashkëpunim me Komunën e Vushtrrisë; (përgjegjesi e VoRAE-së);
- 2.2 Hartimi i dizajnit arkitekturor për modelin tipik të shtëpive të banimit; (përgjegjësi e VoRAE-së);
- 2.3 Ndërtimi i modelit të shtëpive të banimit; (përgjegjësi e VoRAE-së);
- 2.4 Zhvillimi i projekteve për investime kapitale sipas Planit Tre Vjecar të Banimit Social dhe Planit Zhvillimor Komunal dhe gjetja e donatorëve/investitorëve me qëllim të riorganizimit të vendbanimit në Fshatin Prilluzhë. (përgjegjesi e VoRAE-së dhe Komuna).



Neni 3

Kushtet dhe parimet e përgjithshme të të dyja palëve

Komuna dhe Organizata zotohen që do të ndjekin politikat dhe legjislacionin në fuqi, do të implementojnë projektin sipas standardeve të ndërtimit duke mbrojtur interesin më të mirë të qytetarëve, do të praktikojnë parimet si: transparenca, jo-diskriminimi dhe bashkëpunimi.

Neni 4

Vlera e Projektit

Vlera e tërësishme këtij projekti është: 240,000.00 € (dyqind e katërdhjet mijë euro), prej të cilave:

4.1 Komuna e Vushtrrisë do të bashkëfinancoj me mjete financiare nga buxheti i saj në vlerë prej 80,000.00 € (të dhjetë mijë euro),

4.2 OJQ “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve” do të financoj me mjete në vlerë prej 160,000.00 € (njëqind e gjashtëdhjet mijë euro).

Neni 5

Veprimet dhe përgjegjësitë e Komunës së Vushtrrisë

5.1 Komuna do të bashkëfinancojë aktivitetet në vlerë 80,000.00 € (të dhjetë mijë euro) gjatë vitit 2025 për të arritur qëllimet e lartëshënuara;

5.2 Komuna merr përgjegjësinë për miratimin dhe mbështetjen profesionale të organizatës për përgaditjen e analizës së kost-benefitit, revidimin e Planit Tre Vjecar të Banimit Social dhe zhvillimin e zgjidhjes urbane në përputhje me legjislacionin në fuqi;

5.3 Komuna merr përsipër të sigurojë parcelën dhe infrastrukturën e nevojshme publike për ndërtimin e 5 (pesë) shtëpive për banorët e fshatit Prelluzhë të komunitetit RAE;

5.4 Komuna merr përsipër të sigurojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, kushtet dhe lejen e ndërtimit të shtëpive në varg sipas zgjidhjes urbane të hartuar nga organizata dhe të bazuara në legjislacionin në fuqi;

5.5 Komuna do të zhvillojë projekte për investime kapitale sipas modelit të shtëpive duke u bazuar në Planin Tre Vjecar të Banimit Social dhe PZHK-së në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturë.

5.6 Komuna do të emërojë një person kontaktues i cili do të jetë përgjegjës për koordinim të punëve gjatë procesit të implementimit të marrëveshjes së bashkëpunimit.



Neni 6

Veprimet dhe përgjegjësitë e OJQ Zëri i Romëve, Ashkalis dhe Egjiptianëve

- 6.1 Organizata zotohet që do të bashkëfinancojë këtë projekt sipas kësaj marrëveshje me mjete financiare në vlerë prej 160,000.00 € (njëqind e gjashtëdhjet mijë euro), sipas dispozitave dhe buxhetit të projektit “Drejtësia Sociale për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian”.
- 6.2 Organizata merr përsipër të zhvillojë të gjitha procedurat e prokurimit për të kontraktuar kompanitë me synim të realizimit të qëllimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshjeje në bashkëpunim të ngushtë me Komunën;
- 6.3 Organizata do të hartojë projektin ideor dhe zbatues të mostrës tipike të shpisë bazuar në legjislacionin në fuqi dhe zgjidhjen urbane të propozuar;
- 6.4 Organizata do të udhëheqë procesin e ndërtimit të shtëpive në varg sipas zgjidhjes urbane të propozuar dhe standardeve të ndërtimit në fuqi;
- 6.5 Organizata do të ofrojë mbështetje profesionale Komunës në zhvillimin e projekteve për investime kapitale;
- 6.6 Organizata do të emërojë një person kontaktues i cili do të jetë përgjegjës për koordinim gjatë procesit të implementimit të marrëveshjes së bashkëpunimit.

Neni 7

Detyrimet financiare dhe plani financiar

FAZA e I-rë:

Periudha përgatitore, viti 2024

- 7.1 **Ofrimi i ekspertizës për revidimin e Planit Tre Vjecar të Banimit Social** për Komunën e Vushtrrisë ka një kosto financiare prej 500.00 € (pesëqindë euro) që do të sigurohen/paguhen nga Organizata Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve.
- 7.2 **Hartimi i projektit ideor dhe zbatues për mostrën tipike të shtëpive** të cilat do të ndërtohen: Buxheti i paraparë për hartimin e projektit ideor dhe zbatues është 3,000.00 € (tremijë euro). Këto mjete do të ndahen nga Organizata Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve.



FAZA e II.:

Periudha implementuese, viti 2025

Fillimi i ndërtimit të mostrave tipike të shtëpive

7.3 Buxheti i paraparë për ndërtimin e 3 (tre) mostrave tipike të shtëpive (pesë shtëpi banimi) është 240,000.00 € (dyqind e katërdhjet mijë euro) prej të cilave Komuna e Vushtrisë do të ndajë 80,000.00 € (tetëdhjet mijë euro) ndërsa Organizata Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve 160,000.00 € (njëqind e gjashtëdhjet mijë euro).

7.4 Bartja e mjeteve nga Komuna e Vushtrisë për vitin **2025** në llogarinë e organizatës Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve do të bëhet si në vijim:

7.5 Pagesën e kështit të I-rë prej 40% (24,000.00 euro) nga totali, Komuna do ta bëjë tek organizata “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve”, pasi që organizata do të kontraktojë kompaninë për furnizim me material ndërtimor dhe kompaninë për ndërtimin e mostrave tipike të shtëpive.

7.6 Pagesën e kështit të II-të prej 60% (56,000.00 euro) nga totali, Komuna do ta bëjë tek organizata Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve, pasi që dorëzohet në Komunë raporti i progresit të punimeve në teren i përgatitur së bashku me mbikëqyrësit e autorizuar nga Komuna e Vushtrisë.

7.7 Mjetet financiare të përmendura në nënparagrafët paraprak, Komuna e Vushtrisë do t'i transferojë në xhirollogarinë e organizatës “Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve” në numër të llogarisë bankare 1167002199000133, në ProCredit Bank.

7.8 Çdo obligim shtesë që mund të dal mbi shumën e shënuar në pikën 4.1 të të nenit 4, do ta financoj organizata “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve”.

7.9 Mjetet financiare eventualisht të mbetura pas përfundimit të projektit nga kjo marrëveshje duhet të iu kthehen bashkëfinancuesve sipas përqindjes së mjeteve me të cilat kanë participuar.

Neni 8

Dispozitat përfundimtare

8.1. Ndryshimet në Marrëveshje mund të bëhen vetëm me shkrim, duke nënshkruar Aneksin, me pëlqimin e të dy palëve.



8.2 Palët bien dakord që të gjitha sfidat në arritjen e bashkëpunimit të plotë do të arrihen me marrëveshje.

8.3 Në rast se kjo marrëveshje nuk respektohet, atëherë palët janë të obliguara të njoftojnë palën tjetër 30 ditë më herët për shkëputjen e marrëveshjes.

8.4 Kjo marrëveshje është bërë në dy ekzemplarë në origjinal, në formatin A/4, për secilën palë nga një.

8.5 Palët bien dakord, se në rast të sigurimit të donacioneve shtes të vazhdohet bashkëpunimi me nënshkrimin e Aneks Marrveshjes mes dy palëve.

Neni 9 Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit dhe është valide deri në përfundimin e DY FAZAVE. FAZA e I-rë viti 2024 dhe FAZA e II.-të viti 2025, përkatësisht deri më 31 Dhjetor 2025, me mundësi zgjatjeje në rast të pengesave reale apo sigurimit të mjeteve shtesë për vitin/vitet vijuese.

PALËT NËNSHKRUESE

